

Thirrje për pjesëmarrje me kontribut

Për konferencën ndërkombëtare

“Roli i gruas në elitat e mijëvjeçarit të parë para Krishtit në hapësirën mes Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor”

I. Objekti

Muzeu i Historisë së Natyrës i Vjenës (MHN) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë po organizojnë së bashku një konferencë shkencore ndërkombëtare, që do të zhvillohet më 13-15 maj 2025 në Vjenë, me temën:

“Roli i gruas në elitat e mijëvjeçarit të parë para Krishtit në hapësirën mes Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor”

Konferenca do të prezantojë dhe diskutojë aspekte të ndryshme të rolit të grave si pjesëtare të elitës në periudhën historike të përcaktuar në titull.

Konferenca do të fokusohet gjithashtu në diskursin shkencor mbi kulturën materiale shoqëruese: mallrat e shtrenjta/prestigjioze, rrugët tregtare dhe rrjetet përkatëse të komunikimit.

Për ta përfshirë këtë problematikë në një kornizë më të gjerë, do të preken edhe koncepte teorike mbi strukturën shoqërore dhe identitetet gjinore në mijëvjeçarin e parë para Krishtit.

Objekt diskutimi: Gjetjet e varreve në veçanti janë në gjendje të demonstrojnë një pamje mbresëlënëse të rolit të diferencuar të elitës femërore dhe funksioneve të tyre komplekse sociale, politike, të kultit e fetare, bazuar në veçoritë e tyre specifike.

Shkak për konferencën është statuja e shquar prej bronzi e të ashtuquajturit “Kalorësi i Babunjës”, zbuluar në një vendbanim ilir pranë Apolonisë / Shqipëri. E gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike shqiptaro-gjermane në vitin 2018, pas restaurimit të mëparshëm në Muzeun “Getty” në SHBA dhe kthimit të veprës së artit në Shqipëri, është planifikuar që ajo të prezantohet për publikun në mjediset e MHN (Muzeu Historik të Natyrës), në “Kabinetin e Artë”, në vitin 2025, në kohën e mbajtjes së konferencës e vijim.

Statuja e punuar në periudhën e vonë arkaike (rreth viteve 530/520 p.e.s.) në ndonjë punishte helene përfaqëson një kryevepër artistike unike të skulpturës helenike të bronzit. Ndonëse kalorësi mban armë, për shkak të veçorive stilistike të periudhës arkaike, mbetet e paqartë nëse bëhet fjalë për kalorës apo ndoshta edhe kalorëse (femër). Në këtë rast do të kishim të bënim me një përshkrim të një amazone të montuar.

Përshkrimet e amazonave janë veçanërisht të zakonshme në Iliri në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë para Krishtit. Ato janë gjetur disa herë rreth shekullit të dytë para Krishtit dhe janë shumë të njohura. Pa dyshim, ato pasqyrojnë statusin e lartë shoqëror e politik, por edhe atë të kultit e fetar të gruas brenda elitës ilire, e cila tregonte kështu aftësinë e saj mbrojtëse dhe barazinë.

Shembulli më i spikatur është mbretëresha ilire Teuta, e cila pasoi në fron burrin e saj Agronin nga fisi labeat dhe që sundoi nga viti 230 deri në vitin 228 p.e.s.; si dhe gjysmëmotra e Aleksandrit të Madh, Cynane, vajza e mbretit maqedonas Filipi II dhe princeshës ilire Audata / Eurydice, e cila ishte e famshme për karakterin e saj luftarak dhe thuhet se e kishte portretizuar veten si një amazonë.

Dëshmitë arkeologjike për gratë si pjesëtare të shquara të elitës do të sillen për mijëvjeçarin e parë para Krishtit. Megjithatë, objekti i konferencës nuk kufizohet vetëm në Iliri, por mund të gjenden shembuj të shumtë të ndryshëm në një zonë të gjerë nga Europa Qendrore deri në Ballkanin Jugor.

II. Informacion rreth prezantimeve

Regjistrimi: Tema e sugjeruara, duke përfshirë një përmbledhje të shkurtër (maksimumi 200 fjalë, anglisht ose gjermanisht), duhet të dërgohen në adresën barbara.hirsch@nhm-wien.ac.at Formulari i aplikimit do të publikohet së shpejti.

Afati i fundit i regjistrimit për prezantime: 20 nëntor 2024

Ligjërata: Përveç ligjëratave me kohëzgjatje të të folurit 20 minuta, ofrohet edhe opsioni për ligjërata të shkurtra me kohë të të folurit 10 minuta. Gjuha e ligjëratave do të jetë anglisht ose gjermanisht.

Poster: Kontributet në formën e një prezantimi me postera janë gjithashtu të dëshirueshme; ato mund të diskutohen me autorët në një kohë të veçantë.

Publikimi: Koha e publikimit të kontributeve do të bëhet e ditur më vonë.

III. Informacione organizative për konferencën

Koha e mbajtjes: 13-15 maj 2025

Vendi: Muzeu Historik i Natyrës, Vjenë, salla nr. 16, Burgring 7, 1010 Vjenë

Organizatorë: Muzeu Historik i Natyrës në Vjenë dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në Austri.

IV. Komiteti organizativ:

Georg Tiefengraber: georg.tiefengraber@nhm-wien.ac.at

Adem Bunguri: bunguria1@gmail.com

Karina Grömer: karina.groemer@nhm-wien.ac.at

Artan Canaj: artan.canaj@mfa.gov.al

Sekretariati i konferencës: Barbara Hirsch: barbara.hirsch@nhm-wien.ac.at

V. Program paraprak mbështetës për konferencën

Më datën 13 maj 2025 në mbrëmje do të zhvillohet një pritje e organizuar nga Ambasada e Shqipërisë, me një program mbështetës kulturor shqiptar. Në këtë pritje do të prezantohet edhe figura e “Kalorësit të Babunjës”, në “Kabinetin e Artë” të MHN.

Si një program mbështetës, ofrohen gjithashtu ture speciale në koleksionet e MHN, të Muzeut Historik të Artit dhe të Parkut Arkeologjik “Carnuntum”.